



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:107730

Datë: 07.05.2021

Numri i dokumentit: 01766801

C.nr.689/17

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Afërdita Mulhaxha, me çështjen juridike kontestimore të paditëses Z. M., nga fshati, Komuna e, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Sh. Gj., avokat në Pejë, kundër të paditurës „.....” L.L.C, Zyra Qendrore, në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Isamedin Dedinca, avokat në Prishtinë, për kompenzim të dëmit, vlera e kontestit: 48.349,00€, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të mbajtur me dt.15.04.2021, në prezencën e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse me dt.05.05.2021, bie këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Z. M., nga fshati, Komuna e, ashtu që:

I. DETYROHET e paditura „.....” L.L.C, zyra qendrore në Prishtinë, që paditëses Z. M., nga fshati, Komuna e, që në emër të kompenzimit të dëmit materiale për vendosjen e kabllove optike në pjesën e ngastrës kadastrale nr.00014-0 ZK, t'ia paguaj shumat e specifikuar si më poshtë, dhe atë:

- kompenzim në emër të dëmit të shkaktuar gjatë punimeve, shumën prej 3.247,56€,
- kompenzim në emër të humbjes së vlerës, shumën prej 21.347,29€,
- kompenzim në emër të kamatës për dëmin e shkaktuar gjatë punimeve, dhe vlerën e humbur, në shumë prej 13.776,00€.

II.DETYROHET e paditura „.....” L.L.C, Zyra Qendrore në Prishtinë, që të kthej pjesën e paluajtshmerisë nr. 00014-0 ZK, në gjendjen para vendosjes së kabllove optike, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

III. REFUZOHET kërkesëpadia e paditëses Z. M., nga fshati, Komuna e Pejës, e cila ka kërkuar që të detyrohet e paditura „.....” L.L.C, Zyra Qendrore në Prishtinë, t'ia paguaj shumat e specifikuar si në vijim: në emër të qirasë vjetore (prej vitit 2013 deri me vitin 2019), shumën prej 9.240,00€, në emër të kamatëvonesës për qiranë vjetore (prej 2013 deri në vitin 2019), shumën prej 739,00€, në emër të kompenzimit për kthimin e paluajtshmerisë nr.00014-0 ZK, në gjendjen para vendosjes së kabllove optike, shumën prej 3.000€, SI E PA BAZUAR.

IV. DETYROHET e paditura „.....” L.L.C, zyra qendrore në Prishtinë, që paditëses Z. M., nga fshati, Komuna e Pejës, për shumat e gjykuara si në pjesën e I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 38.370,85€, me kamatë prej 8% në vit, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit dt.29.04.2021, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 3.650,00€, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësja me padi, precizimin e saj, të bërë më dt.03.03.2020, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, e nëpërmjet të autorizuarit të saj, ka parashtruar se e paditura që nga muaji shtator i vitit 2012, ka hapë infrastrukturë nëntokësore-kanal, në patundshmërinë private të paditësit në thellësi prej 2m, dhe në gjatësi prej 400m, dhe pa pëlqimin e paditëses ka vendosur kabllot fibrit optikë, të cilat shërbejnë për lidhje ndërkombëtare të Telekomunikimit me R të Malit të Zi, e më gjerësi në një largësi prej 400m, ku realizon edhe përfitime milionëshe në vit. Me të gjitha provat e administruara si me daljen e gjykatës në vend shikim së bashku me ekspertin e gjeodezisë dhe ekspertin e elektros, me dt.06.10.2017, dhe ekspertizën për vlerësimin e pronave të paluajtshme, në mënyrë të plotë dhe të pa kontestuar është vërtetuar bazueshmëria e kërkesëpadisë së paditësit. Në mënyrë të pa kontestueshëm është vërtetuar fakti se paditësja është pronarë ligjor dhe faktik i parcelës nr.00014-0 ZK-....., dhe se paditura pa pëlqimin paraprak, pa marrëveshje me paditësen në pronën private të saj, ka bërë gropimin, gjatë tërë gjatësisë së ngastrës së paditëses për 265.76m, ka vendosur gypa plastike dhe kabllot fibrit optik, dhe e paditura realizon përfitime financiare nga shërbimet e internetit në vend dhe në linjën ndërkombëtare.

I njëjti, ka theksuar se e paditura që nga dt.01.09.2012, ka qenë në dijeni se e shfrytëzon pronën e huaj në rastin konkret pronën e paditëses, dhe paditësja disa herë ka kërkuar nga e paditura që të arrihet një marrëveshje për lidhje të kontratës për pagesën e qirasë për shfrytëzimin e patundshmërisë së saj, dhe i është drejtuar me shkrim me dt.07.04.2017, e paditura nuk ka qenë e gatshëm për arritje të një marrëveshje, ashtu që bazuar në dispozitat ligjor nga nenin 202 të LMD-së, që përcakton çështjen e shfrytëzimit të sendit të huaj në dobi për vetën, është i obliguar që ta kompensojë, se kjo është e rregulluar edhe sipas nenin 46 të Kushtetues se Republikës se Kosovës, pra në rastin konkret e paditura ka shkelur këtë nen, dhe kjo është e rregulluar dhe sipas nenit 18 të Ligji për Pronësisë dhe të Drejta Tjera Sendor, se askush nuk mund të privohet nga e drejta e pronësisë dhe nuk mund ta shfrytëzojë, as të tjetërsohet pronën private pa u realizuar shpërblimi i drejtë dhe në kohë, mos realizimi i kompensimit të drejtë, cenon edhe nenin 1 të Protokollit nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenin 46, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ashtu që i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses ta aprovoj në tërësi si të bazuar, duke i kërkuar shpenzimet e procedurës dhe atë në lartësi prej 4.748€, dhe atë për përpilim të padisë shumë prej 208€, për përfaqësim në 12 seanca (nga 208€), në total shumë prej 2.970€, për 5 parashtrës nga 208€, shumë prej 1.040€, për taksë për padi shumë prej 40€, për shërbimin për ekspert për vlerësimin e paluajtshmerisë shumë prej 300€, për shpërblimin për ekspertizë të gjeodezisë shumë prej 120€, për shpërblimin për ekspertizë të telekomunikacionit shumë prej 70€.

E paditura nëpërmes të autorizuarit të saj, në përgjigje në padi, gjatë shqyrtimit kryesor dhe fjalës përfundimtare, e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar, për faktin se vendosja e kabllorëve skajit rrugës së asfaltuar, me vendim të organit shtetëror, paditëses nuk i është shkaktuar kurrfarë dëmi. E paditura me vendim të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Komunës së Pejës, me të cilën i është lejuar gropimi për shtrirjen dhe vendosjen e kabllorëve optike duke shfrytëzuar brezin rrugor të rrugës Nacionale M9, drejtimi Pejë-Kuqishtë, të cilin e konsideron se si fakt të pa kontestuar, se nëse merret parasysh fakti se kabllot optike janë vendosur skajit rrugës së asfaltuar e në bazë të një vendimi të organit shtetëror, në rastin konkret Ministrisë së Infrastrukturës, rezulton se kërkesëpadia e paditëses është e pa themeltë pasi që në këtë parcelë është shtruar rruga me asfalt dhe kjo rrugë nuk e pengon paditësin atëherë si është e mundur t'i pengoj kabllot për skaj rrugës së asfaltuar. Ka shtuar se në bazë të mendimit të ekspertit gjeodet është vërtetuar fakti se e paditura ka shtrirë kabllot optike në rrugën lokale dhe jo në një pjesë të paluajtshmerisë së paditëses, që paditëses t'i pamundësohet puna, respektivisht punimi i tokës që do të rezultonte me dëme që konsiston me fitimin e humbur, por kabllot optike janë shtrirë skaj rrugës lokale, e që paditëses në asnjë

mënyrë nuk i cenohet e drejta në kërkesën e saj sepse për këtë shtrirje ka vendosur Ministria e Infrastrukturës, dhe që e paditura për këtë shtrirje ka paguar taksen për m² të kabllos, sipas rregullores së Komunës së Pejës dhe Ministrisë së infrastrukturës.

Kërkesëpadia e paditëses e precizuar për pagesën e qirasë për shfrytëzim të paluajtshmerisë dhe kërkesën për kthimin në gjendjen e mëparshme, janë kërkesa të pabazuara, pasi që padia e paditëses përveç që është e pathemeltë është edhe kundërthënëse, sepse me padi kërkohet: kompensimi i qirasë ndërkaq palët ndërmjet veti nuk kanë kurrfarë kontrate mbi qiranë; se me padi kërkon kompensimin në shumë prej 3000€, për kthimin në gjendje të mëparshme të patundshmërisë, ndërkaq e paditura bazuar në vendimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Komunës së Pejës, e ka kthyer në gjendje të mëparshme, dhe ky fakt është i pa kontestuar.

E paditura komfor vendimit të Ministrisë së infrastrukturës dhe të Komunës së Pejës, ka shtri kabllo optike që është në interes publik, sepse e paditura ushtron shërbime publike pavarësisht që është kompani private dhe që në bazë të kësaj kabllo optik bëhet lidhje ndërkombëtare e komunikimeve elektronike, e që kjo është përcaktuar edhe me dispozitat e nenit 22 par 1 të Ligjit për Komunikime Elektronike, dhe kjo vendosje e kabllos optike, tani përbën një servitut i cili është vendosur nga organi shtetëror si çështje e përcaktuar me dispozitën e nenit 253 par 1, të Ligjit për Pronësi dhe të Drejtat Tjera Sendore, me këtë dispozitë ligjor është përcaktuar se servituti sendor është e drejt e pronarit të një paluajtshmerie (*paluajtshmeri dominuese*) që një paluajtshmeri tjetër (*paluajtshmeri shërbyese*) në një mënyrë të caktuar ta shfrytëzoj apo të ndaloj kryerjen e veprimit të caktuar ose të përjashtoj ushtrimin e një të drejte të përcaktuar të cilat rrjedhin nga e drejta e pronësisë në paluajtshmerinë shërbyese si dhe neni 253 par 2, të të njëjtin ligj përcakton se servituti sendor krijohet në bazë të një pune juridike, një vendimi të organi shtetërorë ose ligjit.

E paditura e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditëses si të pa themeltë, edhe për faktin se bazuar në dispozitat ligjore në fuqi ka të drejt që në përputhje me lejen përkatës komunale të ministrisë të përdor pa pages brezin rrugor të rrugës publike për shtrirjen e kabllos optik dhe në bazë të dispozitës së nenit 27 të Ligjit për Rrugët, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-120, ku është përcaktuar se „*Shfrytëzimi i rrugës publike pjesëve të saja brezit rrugor dhe brezit mbrojtës për nevojat publike të përgjithshme si vënia e kabllove të telekomunikacionit dhe gypave të ujit dhe lidhjeve ajrore dhe nëntokësore duhet të jetë me pëlqim dhe mbikëqyrjen e Ministrisë për rrugët magjistrale dhe regjionale dhe në mbikëqyrjen e komunës për rrugët lokale*”. Ndërsa në bazë të nenit 23 par 1 të Ligjit për Komunikimet Elektronike është përcaktuar se „*Pas koordinimit të veprimeve të tyre në pajtueshmëri me kërkesën e legjislacionit përkatës, më institucione shtetërore qendrore ose komunale operatorët mund të përdorin brezin rrugor komunal dhe shtetëror sheshet, tubacionet, rrjetin e ujësjellësit, urat, viaduktet, tunelet dhe strukturat tjera për ndërtimin e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike pa pages ose me pages minimale për t'i mbuluar shpenzimet administrative të institucionit përkatës*” e që këto pagesa në rastin konkret e paditura i ka paguar për m² Komunës së Pejës, pra në baze të këtyre dispozitave ligjore e paditura është liruar nga çfarëdo pagese për kompensimin eventual pasi që shtrirja e kabllos duke përdoruar rrugën publike (brezin rrugor të rrugës nacionale M9) dhe ka paguar taksen administrative, atëherë duke i marr për bazë këto rrethana i autorizuari i të paditurës konsideron se kërkesa e paditëses është e pabazuar, dhe i njëjti i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj si të pa themeltë në kuptim të nenit 399 të LPK-së. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për përgjigje në padi, shumen prej 208€ dhe për 10 seanca të mbajtura për secilën nga 270€, apo shumen e tërësishëm prej 2.908€.

Gjykata me propozimin e palëve për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike-kontestimore, zhvilloj procedurën e provave ku u administrua si provë: certifikata e pronës e dt.14.06.2016; vërejtja para ushtrimit të padisë drejtuar të paditurës me

dt.07.04.2017, përgjigja e të paditurës me dt.29.05.2017; Aktvendimi Komunës së Pejës-Drejtoria për Punë Komunale dhe Shërbime Publike, me nr.2208/2012, i dt.17.08.2012; orto foto e pronës lëndore e dt.14.08.2017, dhe procesverbali i daljes në vend shikim me dt.06.10.2017; ekspertiza e ekspertit gjeodet F. H. e dt.06.10.2017, bashkë me raportin me shkrim, kopjen e planit, skicën e matjes, orto foton, certifikata e pronës; ekspertiza e ekspertit gjyqësor Mr. M. H., ing. i elektros e dt.18.10.2017; rregullorja për shërbimet komunale, mars 2011; ekspertiza për vlerësimin e paluajtshmerisë, e ekspertit Sh. J.-vlerësues i pronave të paluajtshme; projekti i grupimit Pejë-....., e dt.24.05.2012, si dhe deklaratimet e te autorizuarve të palëve ndërgjyqëse.

Pasi që gjykata, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjitha së bashku e në lidhshmërinë reciproke me njëra tjetrën, në kuptim të nenit 8 të LPK, ka ardhur në përfundim se në këtë çështje juridike civile, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që vërtetoj këtë gjendje faktike:

-se paditësja Z. M., nga fshati, Komuna e Pejës, evidentohet si pronare e parcelës kadastrale nr.00014-0 ZK, Me aktvendimin Komunës së Pejës-Drejtoria për punë komunale dhe shërbime publike nr.10-352-6693/2012, e dt.29.08.2012, gjykata, ka konstatuar se të paditurës IPKO-së, i lejohet grupimi i kanalit për shtirje të fibrës optike në rrugën Kuqisht-....., duke e obliguar që dëmet eventuale në infrastrukturën nëntokësore t'i rikthej në gjendje të mëparshme, dhe pas grupimit të kanalit t'a mbuloj me zhavorr.

Se nga vendimi i Ministrisë së Infrastrukturës nr.2208/2012, i dt.17.08.2012, rezulton se të paditurës IPKO Telekomunikacionit LLC, në Prishtinë, i iepet pëlqimi për shtrirje të kabllos optike që fillon nga puseta ekzistuese e IPKO-së PO1, në anë e djathtë të rrugës nacional M9, drejtimi Pejë-Kuqishtë dhe mbaron në puseten P.45 në Kuqishtë, me të gjitha të drejta dhe detyrimet sikur në këtë vendim.

Nga vërejtja para ushtrimit të padisë, paraqitur nga i autorizuari i paditëses me dt.07.04.2017, rezulton se paditësja nëse do të jetë e pa kënaqur nga një përgjigje e këshilltarit të paditurës, e paralajmëron të paditurën se nëse nuk i ofron një zgjidhje me pretendimin për lidhje të kontratës së qirasë apo kompenzim, duke marr për bazë se vendosja e kabllove optike në pronën privat është bërë pa pëlqimin paraprak të paditëses, dhe për çdo veprim të paditëses, e paditura vet do t'i bartë pasojat...(me gjerësisht sikur në këtë shkresë).

Paditësja me padinë e dt.11.07.2017, ka kërkuar nga gjykata që ta detyroj të paditurën që të paguaj nga 1.000€, për muaj në emër të shfrytëzimit të pronës së paditëses (si qira mujore), që nga dt.01.09.2012, deri në ditën e lirimit të pronës lëndore.

Gjykata me propozimin e të autorizuarit të palës paditëses ka bërë nxjerrjen e provës me ekspertizën e Inxh. të elektros, ekspertizën e gjeodezisë si dhe ekspertizën për vlerësimin e pronave të paluajtshme.

Nga ekspertiza e ekspertit të elektros Mr. M. H., e dt.18.10.2017, gjykata ka konstatuar se në ngas. kad. nr.14-0 ZK, nëpër këtë njësi përbri rrugës kalon infrastruktura e telekomunikimit nëntokësor e të paditurës, kablo optik me kapacitet 96 fitor, i vendosur në gyp FI-60 mm, në thellësi prej 75 cm, në gjatësi prej 265,76 m, ku në parcelën fqinje nr.20, në pronësi të Shkëlzen Mekaj, ishte vendosur një pusët e thellë 1,6 m, e shenjzuar si PO2, se eksperti ka konstatuar se infrastruktura e telekomunikacionit është realizuar sipas normave dhe standardëve të parapara, dhe në këtë kanalizim janë vendosur edhe 3 gypa të tjerë rezervë për zgjerimin e shërbimeve në të ardhmë, në mënyrë që mos të dëmtohet infrastruktura rrugore.

Nga ekspertiza e eksperti gjeodet Faruk Hysenaj, gjykata ka vërtetuar se ngastra kadastrale nr.14-0, me kulturë livadh, klasa e parë në sipërfaqe prej 30752 m², evidentohet në emër të Z. M., nga fshati, se pas matjeve të detajuara në teren është vërejtur se kablo e internetit është vendosur përafërsisht në mes parcelës nr.14-0, drejtimi jug-veri në gjatësi prej 265.76m, të shënuara në skicën e matjes me ngjyrë të kuqe, duke filluar nga pika nr.1 gjerë në

pikën nr.8, ndërsa „shahti”, i cili gjendet në vend është vendosur në parcelën fqinje nr.20, në skicën e matjes me ngjyrë të zezë janë paraqitur kufijtë kadastral, ndërsa me ngjyrë të kuqe shtrirja e kabllorikut përgjatë parcelës nr.14.

Nga ekspertiza për vlerësimin e paluajtshmerisë, e punuar nga eksperti Sh. J., me dt.06.01.2020, dhe nga konstatimet e ekspertit në seancën gjyqësore të dt.10.02.2021, rezulton se kërkesa e paditëses për kompenzim të dëmit material për shkak të vendosje së kabllorëve optike në pronën e saj, ndahet si në vijim:

-çmimi për ngastrën nr.14-0, ne sipërfaqe prej 30.752 m², është në shumën prej 17.46€/m², dëmi i shkaktuar gjatë punimeve të gropimit për vendosjen e kabllorëve fibër-optik, është prej sipërfaqes 186m²×17.46€, në shumën totale prej 3.247,56€, vlerësimi i humbjes së vlerës $30.566 \times 17.46 = 533,682.26 \times 4\% = 21.347,29\text{€}$, kamata e llogaritur për vlerën e humbur në shumën prej 13.776,00€, qiraja vjetore (prej 2013 deri me 2019), në shumë prej 9.240,00€, dhe kamatëvonesa e qerases (prej 2013 deri me 2019), në shumën prej 739,00€, e në shumën e tërësishëm prej 48.349,00€.

Për gjykatën, nuk ishte kontestuese fakti, se e paditura, në bazë të vendimit të organit shtetërorë, pra Ministrisë së Infrastrukturës dhe Komunës së Pejës, ka pasur për obligim që t'i vendos kabllot optike vetëm për skaj rrugës së asfaltuar, drejtimi Pejë-Kushiqshtë-.....

Nuk ka qenë kontestuese as rrethana se ku janë vendosur-shtri kabllot optike për gjatë ngastrës kad.nr.14-0 ZK, në gjatësi prej 265,76 m, që është në pronësi private, respektivisht pronë e paditëses.

Në këtë çështje juridike në mes palëve ishte kontestuese çështja se kërkesëpadia e paditëses, a ka apo nuk ka, bazë ligjor për kompenzimi në emër të dëmit të shkaktuar, kompenzimi i humbjes së vlerës së paluajtshmerisë, kompenzimi për kthimin në gjendje të mëparshme, respektivisht largimin e kabllorëve nga prona e paditëses, si dhe kompenzimi në emër të qirasë dhe kamatëvonesa.

Bazuar në këtë gjendje të vërtetuar faktike, duke u mbështetur në provat materiale, e sidomos duke u mbështetur në ekspertizat e eksperteve të lartcekur, gjykata vërtetohet se e paditura pa pëlqimin dhe pa marrëveshjen me paditësen, në mënyrë të kundërligjshëm ka shtrirë kabllot optike nëpër pronën e saj, dhe nga shfrytëzimi i pronës së saj, ka përfitime materiale, ndërsa paditëses i ka shkaktuar dëme, dhe i'a ka humbur vlerën e paluajtshmerisë së saj, andaj, kjo gjykatë mendon se kërkesëpadia e paditëses ka bazë ligjore.

Duke u mbështetur në ekspertizat e ekspertit gjeodet dhe ekspertit të elektros, në mënyrë të pakontestueshëm është vërtetuar se e paditura, ka vendosur kabllon e internetit për afërsisht në mes të parcelës nr.14-0, drejtimi jug-veri në gjatësi prej 265.76m, e cila evidentohet në emër të paditëses Z., edhe pse e paditura në bazë të vendimit të organit shtetëror ka pasur për obligim që të vendos kabllot optike, përgjatë brezit të rrugës së asfaltuar, që lidhë qytetin e Pejës dhe fshatin, e jo edhe në pronën e paditëses, andaj, gjykata konsideron se paditëses duhet t'i kompenzohet dëmi i shkaktuar material, si në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimit.

Paditësja me të drejtë thirret se e paditura në mënyrë arbitrare dhe të kundërligjshëm ka vendosur kabllot në pronën e saj dhe gjykata duke u bazuar në ekspertizën e ekspertit për vlerësimin e paluajtshmerive, konsideron se paditësja duhet të kompenzohet në emër të dëmit të shkaktuar gjatë punimeve të gropimit, për vendosjen e kabllorëve fibër-optik, në emër të humbjes së vlerës së paluajtshmerisë (duke llogaritur edhe kamatën), me konkretisht sikurse në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimit.

Nga një gjendje e tillë faktike, kjo gjykata konsideron se baza dhe lartësia e kërkesëpadisë së paditëses, ka mbështetje në nenin 194, par 1 të LMD-së, ku përcakton se „secili person që pasurohet pa bazë ligjor në dëm të tjetrit, është i detyruar të kthejë atë që ka marrë nga tjetri, ose ndryshe të kompensojë vlerën e fitimit të arritur”, dhe par 2. i të njëjti nen përcakton se „fjala pasurim po ashtu përfshinë përvetësimin e fitimit përmes shërbimeve”.

Gjithashtu neni 202 të LMD-së, përcakton se „kur dikush e ka përdorur sendin e huaj për dobi të vet, zotëruesi mund të kërkojë pavarësisht nga e drejta e shpërblimit të dëmit ose në mungesë të kësaj, që ky t'ia shpërblej përfitimin që ka pasur nga përdorimi “.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës me nenin 46 par 1 decidivisht parasheh: „E drejta e pronës është e garantuar”, ndërsa par 3 decidivisht parasheh se: „Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona”.

Protokolli I i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në nenin 1 decidivisht parasheh se: „Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare”.

Gjykata ka vendos si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për faktin se e paditura pa pëlqimin dhe pa marrëveshje me paditësen, në mënyrë të kundërligjshëm i ka shtrirë kablloptike nëpër pronën e saj, andaj e paditura detyrohet që të kthej pjesën e paluajtshmerisë me nr.00014-0 ZK, në gjendjen para vendosjes së kabllove optike.

Lidhur me kërkesën e paditëses që të detyrohet e paditura të paguajë shumat e specifikuar sipas precizimit të kërkesëpadisë të dt.03.03.2020, në emër të qirasë dhe kamatëvonesës (prej vitin 2013 deri ne vitin 2019), gjykata, konsideron se një kërkesë e tillë është e pa bazuar, pasi që palët ndërgjyqëse nuk kane pasur raporte kontraktuale dhe gjykata nuk mund ta detyron të paditurën që të kompenzojë dëmin në emër të qirasë inekzistente, për çka edhe kërkesëpadia e paditëses mbi këtë bazë është refuzuar nga ana e gjykatës.

Njëherit edhe kërkesa e paditëses që të detyrohet e paditura të paguajë shumën prej 3.000€, në emër të kompenzimit për kthimin e pjesës së paluajtshmerisë lëndore, në gjendjen para vendosjes së kabllove optike, për gjykatën është i pa bazuar, pasi që këtë kërkesë e absorbon pika II e dispozitivit të këtij aktgjykimi, ku gjykata e ka detyruar të paditurën, që të kthej pjesën e paluajtshmerisë me nr.00014-0 ZK, në gjendjen e mëparshme.

Sipas dispozitës së nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë t'i paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta, dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa sipas dispozitës së nenit 319 të LPK-ës, secila palë ndërgjyqës, ka për detyrë t'i provoi faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.

Vendimin shpenzimet e procedurës, i mbështeti në nenet 449 dhe 452.1 të LPK-së, ashtu që e paditura është e obliguar që paditëses t'ia paguaj shumën totale prej 3.650€, dhe atë: për përpilimin e padisë shumën prej 208€, për 10(dhjetë) seanca të mbajtura(1 seance 270,40€), në shumë prej 2.704€, për taksën gjyqësore shumën prej 40€, për precizimin e kërkesëpadisë shumën prej 208€, dhe për shpërblimet për ekspertizën: për vlerësimin e paluajtshmerisë në shumë prej 300€, ekspertizën e gjeodezisë në shumë prej 120€, ekspertizën e telekomunikacionit në shumë prej 70€, ndërsa pjesa tjetër e shpenzimeve procedurale refuzohet si e pa bazuar.

Andaj gjykata për arsyet e lartcekurave në kuptim të nenin 143 të LPK-së, ka vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

NGA GJYKATA THEMELORE NE PEJE, C.nr.689/17, dt.05.05.2021.

G j y q t a r j a
Afërdita Mulhaxha

KESHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit ,Gjykatës se Apelit ne Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.